

VENDIM
Nr. 463, datë 26.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 60, DATË 31.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOQSHME PËR VITIN 2018 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 60, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “... 1 989 punonjës.”.

b) Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit të përmendur në pikën 1 të tij, bëhet shtesa e mëposhtme:

“Në ndarjet “Gr. 6, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”; “Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”; “Gr. 11, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”; “Gr. 13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”; “Gr. 14, Ministria e Drejtësisë”; “Gr. 16, Ministria e Brendshme”; “Gr. 18, Shërbimi Informativ Shtetëror”; “Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare”; dhe “Gr. 88, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, shtohen nëndarjet përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar mbulohen nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2018, të njërive të qeverisjes qendrore.

Për punonjësit e kontraktuar për ALUIZNI-n, efektet financiare mbulohen nga të ardhurat e institucionit.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në këtë vendim të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA

Gr.	Emri i Institucionit	Numri punonjesve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	7			
	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	7	Punonjës Arkivi	6 orë/ditë	6 muaj
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10			
	Drejtoria e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë	8	Specialistë	8 orë/ditë	6 muaj
	Dega e Thesarit Vlorë	1	Specialistë	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1	punonjës arkivi	8 orë/ditë	6 muaj
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	3			
	Qendrat Rajonale Rinore Tiranë, Korçë dhe Vlorë	3	Sanitar	4 orë/ditë	6 muaj
13	Ministria Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale	4			
	Qendra Kombëtare Mirëmitjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve	4	Mjek	4 orë/ditë	6 Muaj
14	Ministria e Drejtësisë	150			
	ALUIZNI	140	Specialistë	8 orë/ditë	6 Muaj
	ALUIZNI	10	Teknikë të mesëm	8 orë/ditë	6 Muaj
16	Ministria e Brendshme	2			
	Prefektura Tiranë (Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë)	1	Arkivist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Prefektura Gjirokastrë (Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë)	1	Arkivist	8 orë/ditë	6 Muaj
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	3			
	SHISH (Degët Autonome Tropojë, Pogradec, Himarë)	3	Sanitar	4 orë/ditë	6 Muaj
87	Institucione te tjera qeveritare	20			
	Agjensia Kombëtare e Shoqënisë së Informacionit	20	Specialistë	8 orë / ditë	6 Muaj
88	Agjensia e Mbeshtetjes se Shoqerise Civile	1			
	Agjensia e Mbeshtetjes se Shoqerise Civile	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	200			